



Projekti KSV/023
Rritja e qëndrueshme dhe
gjithëpërfshirëse në Kosovë



NJOFTIM PËR THIRRJE PËR SHPREHJE TË INTERESIT KSV/023•23 6568 (shërbime)

Titulli: Kryerja e një studimi gjithëpërfshirës për identifikimin e boshllëqeve të aftësive në tregun e punës në industri

Buxheti maksimal: 50 000 EUR - Periudha e performancës prej 04 muajsh, parashihet nga shkurti deri në maj 2024.

Agjencia e Luksemburgut për Zhvillim të Bashkëpunimit (LuxDev) publikon thirrje për SHI për blerjen e shërbimeve për kryerjen e një studimi gjithëpërfshirës për të identifikuar boshllëqet e aftësive në tregun e punës në industri, në emër të projektit KSV/023 duke marrë mbështetje financiare nga Qeveria e Duketit të Madh të Luksemburgut.

Ofruesit e shërbimeve që ftohen të shprehin interesin e tyre për të ofruar shërbimet e përmendura më sipër janë:

- *Të gjitha kompanitë e themeluara ligjërisht të rregulluara nga e drejta private, si dhe organizatat joqeveritare dhe organizatat jofitimprurëse (me përjashtim të operatorëve publikë) të regjistruara në Republikën e Kosovës.*

dhe të specializuara në kryerjen e kërkimeve dhe studimeve.

Në mënyrë indikative, ofruesit e shërbimeve do të duhet të demonstrojnë kapacitetin dhe përvojën e tyre teknike në kryerjen e kërkimeve dhe studimeve të ngjashme me përshkrimin e kontratës të shënuar në dosjen e thirrjes për shprehje interesi.

Fillimi i kontratës është parashikuar në shkurt të vitit 2024 për një kohëzgjatje prej 4 muajsh. Ofruesit e shërbimeve duhet të jenë në dispozicion për të gjithë periudhën e paraparë dhe të gatshëm për të ndërhyrë në Republikën e Kosovës. Buxheti maksimal i disponueshëm për këtë kontratë është vlerësuar të jetë 50 000 EUR (përjashtuar të gjitha taksat).

Ofruesit e interesuar të shërbimeve ftohen të paraqesin dokumentacion të mjaftueshëm për t'iu përgjigjur kriterëve të përzgjedhjes. Dosja, përfshirë kriteret e përzgjedhjes dhe formularin për SHI, është në dispozicion sipas kërkesës në adresën e dhënë më poshtë.

Lista e ngushtë e kandidatëve të ftuar për të paraqitur një ofertë të plotë do të krijohet me së paku tre dhe më së shumti tetë kandidatë të vlerësuar si të kualifikuar dhe të renditur, nëse është e nevojshme, në përputhje me kriteret e përzgjedhjes.

SHI, e hartuar ekskluzivisht në anglisht, duhet të dorëzohet në adresën e mëposhtme elektronike ksv023@luxdev.lu jo më vonë se data **21.01.2024 në ora 00:00**, në mesnatë me orën lokale:

Kërkesat për sqarime dërgohen në adresën e emailit të dhënë më sipër.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të ftohen të dorëzojnë një ofertë të plotë.